



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:097145
Datë: 28.12.2023
Numri i dokumentit: 05134008

Ep.nr.115/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Blerta Kelmendi, në çështjen juridike-përmbaremore të kreditorit K.... “.....” SH.A, me seli në Pejë, adresa rrugën ”F. U”, nr...., ndaj debitorit F. S. J. R .D, me adresë në rruga “R. B”, p.n, në Pejë, me bazë juridike përmbaremore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e S. L, nga Peja, kundër Urdhrit të Përmbareuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.br.576/19, të datës 26.07.2019, jashtë seancës gjyqësore, me 28.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si i palejuar prapësimi i paraqitur nga S. L, nga Peja, kundër Urdhrit Përmbaremor P.nr./I.br.576/19, të datës 26.07.2019, të nxjerrë nga Përmbareuesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë.

A r s y e t i m

Kreditori KRM “AMBIENTI” SH.A., me datë 26.07.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve për bartjen e mbeturinave, për periudhën kohore prej datës 01.07.2011 e deri me 30.06.2019, në shumën prej 238.05 euro.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin për përmbartim P.nr./I.br.576/19, të datës 26.07.2019.

Me datën 18.03.2022, paraqitet prapësimi kundër këtij urdhri përmbartimor, i cili është i nënshkruar dhe ka të bashkangjitur një kopje e letërnjoftimit të personit me emrin S. L.

Në prapësim thuhet se faturat e dërguara të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim unë nuk i kam pasur asnjëherë dijeni për shumën e krijuar dhe as nuk jam informuar nga ana e kreditorit dhe asnjëherë nuk kam marrë vërejtje sa i përket borxhit të cekur më lartë. Nga data e pranimit të propozimit për përmbartim jam njoftuar për borxhin me të cilin ngarkohem, prandaj për ecurinë e këtij borxhi nuk kam njohuri dhe sot me datë 15.03.2022, e mora propozimin për përmbartim ku shihet se ky borxh lëndor është parashkruar në bazë të dispozitave ligjore të LMD-së. Duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj urdhrin përmbartimor dhe të obligohet kreditori të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pasi ka vlerësuar shkresat e lëndës, gjen se prapësimi i paraqitur nga personi S. L, duhet të hedhet poshtë si i palejuar, pasi që i njëjti nuk është palë në këtë procedurë përmbartimore.

Kësisoj, në prapësimin e datës 18.03.2022, fillimisht konstatohet se është paraqitur pa emrin e personit që e ka parashtruar, i njëjti vetëm është i nënshkruar tek pjesa e debitorit, por pa u specifikuar se nga kush. Këtij prapësimi i është bashkangjitur një kopje e letërnjoftimit në të cilën figuron emri i personit S. L, mirëpo nuk është bashkangjitur ndonjë provë me anë të së cilës do të vërtetohej se në çfarë cilësie S. L, e ka paraqitur prapësimin në emër të debitorit F.S J. R. D.

Për më tepër, nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se debitori, nuk e ka pranuar propozimin për përmbartim në formën të cilën e kërkon ligji. Përmbartuesi Privat me fletëdërgesën e datës 30.07.2019, ka bërë përpjekje që të ia dërgoj debitorit propozimin për përmbartim, mirëpo që në zarfin e bashkangjitur shkresave të lëndës i kthyer nga posta me nr: R 7510756, si arsyeje e mosdorëzimit figuron “*në këtë adresë nuk ekziston ky emër i pronarit*”, tutje në procesverbalin për dorëzimin e urdhrit për përmbartim të datës 15.03.2022, rezulton se “*urdhri iu dorëzua nuk e*

pranon nënshkrimin-janë me qira”, me çka nuk kemi prova nëse kemi të bëjmë me dorëzim të rregullt të dokumentit ashtu siç parashihet me ligj.

Gjykata në mbështetje të nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (tutje LPP), i cili përcakton se: *“Në procedurën përmbaremore përshtatshëmish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë, ka zbatuar dispozitën e nenit 186 paragrafi 3 të LPK-së, ku parashihet se *“Ankesa është e palejueshme po qe se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*, erdhi në përfundim së prapësimi i paraqitur është i palejuar, ngase është paraqitur nga personi i paautorizuar, për faktin se propozimi për përmbaremore është bërë kundër debitorit F. S. J. R. D., e po ashtu Urdhri për Përmbaremore është lejuar poashtu në emër të debitorit F.S .J .R. D, ndërsa prapësimin e ka paraqitur personi S. L, i cili nuk është palë debitorë në këtë lëndë përmbaremore dhe i njëjti nuk ka sjellë ndonjë provë që do të dëshmonte se është i autorizuar për të përfaqësuar interesat e palës debitorë.

Gjykata poashtu thekson se në shkresat të lëndës është e bashkangjitur një kopje e nxjerrë nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, në të cilën është paraqitur personi Sali Lajqi, si pronar i biznesit S. L B.I., me emër tregtar N.P.T “S. J”, me numër biznesit Gjykata thekson se në rastin konkret nuk ka mundur të merret për bazë ky dokument në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbaremore, për faktin se në rastin konkret procedura përmbaremore ka filluar mbi bazën e ekstraktit afarist nr.22458 dhe 2001854, në të cilin në cilësinë e konsumatorit është debitori F.S.J.R.D, që nga viti 2011 e deri në vitin 2019, ashtu siç është kërkuar edhe në propozimin për përmbaremore nga kreditori e është nxjerrë urdhri përmbaremore nga përmbaremoresi privat, jo ndaj biznesit S.L B.I, me emër tregtar N.P.T “S.J”.

Për më tepër, gjykata potencon faktin se në procedurën përmbaremore zbatohet parimi rigoroz dhe formal, përmes të cilit parim, gjykata nuk është e autorizuar të shqyrtoj pretendimet kontestuese të cilat mund të jenë bazë në ndonjë procedurë tjetër, mirëpo në procedurën përmbaremore, gjykata është e kufizuar vetëm në shqyrtimin formal të elementeve të dokumentit të besueshëm-ekstraktit afarist dhe përputhshmërinë e tij me urdhrin përmbaremore.

Andaj, gjykata mbi bazën e asaj që është thënë më lartë dhe në pajtim me nenin 73 paragrafi 2 dhe 3 të LPP-së, e po ashtu duke zbatuar nenin 17 të LPP-së, si dhe nenin 186 paragrafi 3 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:097145

Ep.nr.115/2022, me datën 28.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës Themelore në Pejë.